

VENDIM
Nr. 171, datë 31.10.2016

MBI SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s ME NR. 88, DATË 26.9.2011, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË EURON ENERGY GROUP” SHPK, PËR AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE” NR. 187, SERIA T11P

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; nenit 5.2, të licencës “Për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016; i ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin mbi shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s me nr. 88, datë 26.9.2011, “Mbi licencimin e shoqërisë Euron Energy Group” sh.p.k., për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, nr. 187, seria T11P,

konstatoi se:

- Shoqëria “Euron Energy Group” sh.p.k., është licencuar në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, përkatësisht me vendimet e Bordit të ERE-s, me nr. 87, datë 26.9.2011 dhe nr. 88, datë 26.9.2011.

- Me shkresën me nr. 268 prot., datë 12.3.2015, shoqëria “Euron Energy Group” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin e licencës së prodhimit dhe tregtimit të shoqëritë: “Euron Energy” sh.p.k., “Alb Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k.

- Me vendimin nr. 54, datë 23.4.2015, Bordi i ERE-s ka vendosur transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Euron Group Energy” sh.p.k., të shoqëritë: “Euron Energy” sh.p.k., “Alb Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k.

- Shoqëritë “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k., kanë aplikuar dhe janë pajisur nga ERE me licencë tregtimi, përkatësisht me vendimet e Bordit të ERE-s nr. 92, datë 28.7.2015 dhe nr. 91, datë 28.7.2015.

- Me shkresën nr. 1 prot., datë 4.1.2016, kemi marrë dijeni se “Euron Energy Group” sh.p.k., ka pushuar aktivitetin e saj dhe tashmë ka mbyllur edhe procedurat e likuidimit e çregjistrimit nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe pranë organeve tatimore.

- Neni 5.2 i licencës “Për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016 parashikon se: *“Nëse i licencuari ndryshon statusin e tij ligjor... licenca bëhet e pavlefshme dhe anulohet”*.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s me nr. 88, datë 26.9.2011, “Mbi licencimin e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike nr. 187, seria T11P”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti